

KURRIKULA, SI BAZË KRYESORE E MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT (Pjesa e I)

PËRMBAJTJA

1. Çfarë është kurrikula?
2. Mësuesi dhe kurrikula
3. Disa nga teoritë e të nxënësit të cilat janë në bazë të kurrikulës (pjesa e I)

Rezultatet e të nxënësit

Pas studimit të këtij materiali, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- Përcaktojnë se çfarë është kurrikula dhe cilët janë aktorët kryesorë të saj;
- Analizojnë se përse teoritë kryesore të të nxënësit janë në themel të kurrikulës dhe të procesit të mësimdhënies.

KONCEPTET KRYESORE

- Kurrikul
- Bihejviorizëm
- Përvojat e individëve
- Fushë studimi
- Antecedent
- Sjellje
- Pasojë

Çfarë është kurrikula?

Për kurrikulën ka përkufizime të shumta. Kurrikula mund të përkufizohet si një plan për veprim ose si një dokument i shkruar, që përfshin strategjitë kryesore për arritjen e objektivave ose të qëllimeve të dëshiruara. Ky këndvështrim, përfaqëson një pikëpamje lineare të kurrikulës, ku rrada e të gjitha hapave është planifikuar paraprakisht, plani ka një fillim dhe një fund, si edhe një proces ose një mekanizëm që kontrollon procesin, me qëllim që ajo që nis të përparojë dhe të përfundojë. Gjithashtu, kurrikula mund të përkufizohet edhe si fusha që trajton përvojat e nxënësit. Kjo pikëpamje quan pjesë të kurrikulës çdo gjë brenda

shkollës, madje edhe atë që është jashtë saj, për atë kohë sa ajo përcaktohet. Një përkufizim tjetër është që kurrikula përfshin të gjitha përvojat që përfitojnë individët nga një program arsimor...që është planifikuar në lidhje me ...teorinë dhe kërkimin ose me praktikën e shkuar e të sotme profesionale.

Kurrikula mund të shihet edhe si fushë studimi me bazat e saj, lëmet e veta të dijes, si dhe me hulumtimin, teorinë, parimet dhe specialistët e vet për interpretimin e kësaj dijeje. Së fundi kurrikula mund të shqyrtohet në lidhje me lëndët si matematika, shkenca, anglishtja, ose përmbajtjen e tyre, që ka të bëjë pikërisht me mënyrën se si ne organizojmë dhe përvetësojmë informacionin. (Orstein & Hunkins, 2003)

Mësuesi dhe kurrikula

Ka teori në bazë të të cilave drejtuesi i institucionit arsimor është dhe eksperti kryesor në rang shkolle përse i përket kurrikulës, megjithatë Dool i kushton mjaft rëndësi edhe rolit të mësuesit në planifikimin dhe në zbatimin e kurrikulës në tre nivele, në klasë, në shkollë, si edhe jashtë saj. Sipas mendimit të këtij autori mësuesi duhet të angazhohet në çdo fazë të përpilimit të kurrikulës, përfshirë dhe planifikimin e objektivave të posaçëm të materialeve, të përmbajtjes, si edhe të metodave të përdorura. Një autor tjetër si Olivia, parapëlqen një konceptim më të gjerë të rolit të mësuesit. Për të, mësuesit duhet të shihen si “grupi parësor në zhvillimin e kurrikulës.” Ata përbëjnë “shumicën në tërësinë e anëtarësisë të komiteteve dhe të këshillave për kurrikulën.” Roli i tyre është që të zhvillojnë, të zbatojnë, si edhe të vlerësojnë kurrikulën.

Sipas Orstein dhe Hunkins, mësuesi e sheh kurrikulën si një të tërë dhe në disa momente, ai shërben si një burim dhe faktor, duke e zhvilluar atë në komitete të ndryshme, duke e zbatuar në klasa dhe duke e vlerësuar si anëtar i një ekipi teknik. Për të garantuar vazhdimësi, integrim dhe njësim të kurrikulës, brenda dhe ndërmjet lëndëve e viteve shkollore, mësuesi mund dhe duhet të përfshihet në mënyrë aktive në kurrikul. (Orstein & Hunkins, 2003)

Disa nga teoritë e të nxëniet të cilat janë në bazë të kurrikulës (Pjesa I)

Bihejviorizmi

Një nga linjat e teorive të të nxëniet perqëndrohet në gjëra që mund të vëzhgohen, pra, te *sjelljet*. Për rrjedhojë, këto teori shpesh klasifikohen në një kategori të përgjithshme që quhet bihejviorizëm (nga Anglishtja *behaviour*: sjellje). Në pikpamje konceptuale, sjelljen mund ta mendojmë si të mbërthyer midis dy grupeve të rrethanave që veprojnë në mjedisin që na rrethon: ato që e paraprijnë atë (antecedentët) dhe ato që e pasojnë atë (pasojat). Kjo marrëdhënie mund të përshkruhet shumë thjesht si lidhja antecedent-sjellje-pasojë, apo A-S-P. Teoritë e sjelljes e analizojnë me kujdes lidhjen A-S-P, duke i kushtuar vëmendje të madhe P-pasojës. Pasojat e një sjellje mund të shtojnë apo të pakësojnë gjasat që sjellja të përsëritet.

Pikpamja bihejvioriste e merr të mirëqënë faktin që rezultati i të nxëniet është ndryshimi në sjellje dhe e vendos theksin te efektet e jashtme mbi individin. Disa nga

bihejvioristët e hershëm, të tillë si J.B. Watson, mbrojnë një pikpamje radikale, sipas të cilës mendimi, qëllimet dhe dukuritë e tjera të brendshme mendore nuk mund të shikohen apo të studjohen në mënyrë rigoroze dhe shkencore. Këto “mentalizma”, siç i quante Watson, nuk mund të përfshihen në shpjegimet e të nxënësve. (Bielhler & Snowman, 2004)

Tabela Nr.1 Përdorimi i bihejviorizmit në klasë

Bihejviorizmi në situatat e të mësuarit në klasë
Në zbatimin e teorive bihejvioriste në klasë mund të përdoren një gamë e gjërë zgjedhjesh. Më poshtë janë dhënë disa sugjerime të cilat janë të vlefshme për mësimdhënien bihejvioriste dhe për situatat e të mësuarit në klasë. 1. Kini parasysh që sjellja është rezultat i kushteve të caktuara; ndryshoni kushtet që të realizoni sjelljet e dëshiruara. 2. Shfrytëzoni përforsimet dhe shpërblimet për të përforsuar sjelljen që dëshironi të nxisni. 3. Kini parasysh se rrallimi i sjelljeve të padëshirueshme çon në zhdukjen ose harresën e tyre. 4. Ulni numrin e sjelljeve të padëshiruara në këto mënyra: a) Frenoni përforsimin ose shpërfillni sjelljen. b) Tërhiqni vëmendjen tek shpërblimet që do të pasojnë sjelljen e dëshiruar. c) Hiqni një privilegj apo përdorni ndërshkimin. 5. Kur nxënësit mësojnë material faktik, shfaqni herë pas here reagimin tuaj; në rastin e materialit abstrakt ose të ndërlikuar, vonojeni reagimin. 6. Zhvilloni praktikë dhe bëni ushtrime përsëritjeje; mbikqyrni ecurinë e nxënësve. 7. Përdorni libra detyrash, materiale të programuara dhe programe kompjuterike që mbështeten në metoda të shkallëzuara. 8. Kur nxënësit ndeshen në një material pa interes, përdorni përforsues dhe shpërblime të posaçme për t'i motivuar. a) Zgjidhni një larmi përforsuesish që nxënësit i pëlqejnë (karamela, çimçakiza, foto të lojtarëve të preferuar) b) Lidhni një kontratë për punën që duhet kryer për të fituar një notë ose shpërblim të caktuar. c) Jepni herë pas here shpërblime të drejtpërdrejta. 9. Përdorni të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit. a) Zgjidhni modelin më të përshtatshëm. b) Modeloni sjelljen qartë dhe me saktësi. c) Këmbëngulni që nxënësit t'i kushtojnë vëmendje asaj që po modelohet. d) Bëni lëvdata kur shfaqet sjellja e dëshiruar. e) Nxiteni nxënësin që të ushtrojë sjelljen e vëzhguar. f) Bëni korrigjimet e duhura gjatë ushtrimit. g) Përsërisni demonstrimet, kur është e nevojshme. h) Përforsoni sjelljet e dëshiruara. i) Modeloni sjelljen në mjedise të ngjashme me ato ku nxënësit do të përdorin shprehitë e reja. 10. Vlerësoni ndryshimet në të mësuarit dhe në sjellje. a) Diagnostikoni problemet e të mësuarit. b) Përcaktoni nivelet e kompetencës apo të aftësisë. c) Shfaqni reagim. d) Integroni detyrat ose shprehitë e vjetra me të reja. e) Shpjegoni përsëri kur është e nevojshme.

f) Merrni masa të tjera.

Burimi: Kurrikula, bazat parimet dhe problemet. Orstein & Hunkins, 2003, fq. 153

Disa karakteristika shumë të rëndësishme të të mësuarit bihejviorist janë paraqitur në tabelën e mëposhteme.

Tabela Nr.2 Përmbledhje e përgjithshme e karakteristikave kryesore të të mësuarit bihejviorist.

<i>Të mësuarit bihejviorist</i>
Ne mësojmë duke vepruar dhe dukë vëzhguar të tjerët. Përforcimi është themelor për realizimin e të mësuarit. Praktika me informim, përmirëson të mësuarin dhe kujtesën. Përsëritjet periodike janë vendimtare për mbajtjen mend të informacionit Të mësuarit nëpërmjet shpërblimit është më i pëlqyeshëm se të mësuarit nëpërmjet ndëshkimit. Të mësuarit kalon nga sjellja e thjeshtë në sjelljen e ndërlikuar dhe nga sjellja e pjesshme në sjelljen e plotë. Të mësuarit duhet të realizohet pjesë pjesë dhe hap pas hapi. Të mësuarit është hierarkik, i mbështetur në gadishmërinë e vazhduar. Ecuria e dëshirueshme dhe rezultatet e të mësuarit duhet të shpallen paraprakisht (dhe me objektiva) Të mësuarit është i vëzhgueshëm dhe/ose i matshëm.

Burimi: Kurrikula, bazat parimet dhe problemet. Orstein & Hunkins, 2003, fq. 192 -193

Bibliografi

Bielhler, R. F., & Snowman, J. (2004). *Psikologji e zbatuar në mësimdhënie*. Tirane: ISP.
Orstein, A. C., & Hunkins, F. P. (2003). *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*. Tiranë: ISP, Fq 38 - 39.
Orstein, A. C., & Hunkins, F. P. (2003). *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*. Tiranë: ISP, Fq 357 - 379
Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: CDE.